UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 11, datë 17. 3.2016

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN E PËRBASHKËT NR. 4, DATË 16.2.2015 TË MINISTRISË SË MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË DHE NR. 2614/1, DATË 19.3.2015 TË MINISTRISË SË FINANCAVE, "PËR KRITERET DHE PROCEDURAT FINANCIARE PËR ZBATIMIN E PROGRAMEVE TË NXITJES SË PUNËSIMIT"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 7995, datë 20.9.1995, "Për nxitjen e punësimit" të ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 47, datë 16.1.2008, "Për progra-min e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë", të ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 48, datë 16.1.2008, "Për programin e nxitjes së punësimit të punë-kërkuesve të papunë në vështirësi, të ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 873, datë 27.12.2006, "Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programit të praktikave profesionale për punëkërkuesit e papunë që kanë mbaruar arsimin e lartë, brenda apo jashtë vendit", të ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 199, datë 11.1.2012, "Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programit të nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë, që hyjnë për herë të parë në punë", të ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 11.1.2012, "Për programin e nxitjes së punësimit të femrave nga grupet e veçanta", të ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 248, datë 30.4.2014, "Për programin e nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuar", të ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 64, datë. 27.1.2016, "Për programin e nxitjes së punësimit të të rinjve, që kanë fituar statusin e jetimit" dhe të nenit 18/1 të Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit miratuar me vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 17.1.1998, "Për miratimin e statutit të shërbimit kombëtar të punësimit", i ndryshuar.

UDHËZOJMË:

Në udhëzimin e përbashkët nr. 4, datë 16.2.2015 të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe nr. 2614/1, datë 19.3.2015, të Ministrisë së Financave, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 5, pjesa I "Klasifikimi buxhetor", paragrafi "Artikulli 603.1", "Subvencion për të nxitur punësimin", të ndryshohet si më poshtë vijon:

"Në këtë artikull do të evidentohet totali i të gjitha shpenzimeve që kanë të bëjnë me "Programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë", sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 47, datë 16.1.2008, të ndryshuar, "Programin e nxitjes së punësimit të punë-kërkuesve të papunë në vështirësi", sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 48, datë 16.1.2008, të ndryshuar "Programin e nxitjes së punësimit të femrave nga grupet e veçanta", sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 11.1.2012, të ndryshuar, "Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programit të nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë, që hyjnë për herë të parë në punë", sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 199, datë 11.1.2012, "Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programeve të praktikave profesionale të punëkërkuesve të papunë që kanë mbaruar arsimin e lartë, brenda apo jashtë vendit", sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 873, datë 27.12.2006, "Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programit të praktikave profesionale për punë-kërkuesit e papunë që kanë mbaruar arsimin e lartë, brenda apo jashtë vendit", të ndryshuar, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 248, datë 30.4.2014, "Për programin e nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuar", të ndryshuar, si edhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 64, datë 27.1.2016, "Për programin e nxitjes së punësimit të të rinjve, që kanë fituar statusin e jetimit"."

2. Pika 5, pjesa I "Klasifikimi buxhetor", paragrafi "Nënartikulli 6031100", "Shpenzime për paga" të ndryshohet si më poshtë vijon:

"Do të përbëhet nga pagat që do t'u jepen punëkërkuesve sipas pikës 7 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 47, datë 16.1.2008, të ndryshuar, pikës 1 "b" të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 48, datë 16.1.2008, sipas pikës 9 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 873, datë 27.12.2006, të ndryshuar, sipas pikës 1 "b" të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 11.1.2012, të ndryshuar, sipas pikës 1 "b" dhe 1 "ç" të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 199, datë 11.1.2012, të ndryshuar, pikës 1 dhe 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 248, datë 30.4.2014, të ndryshuar, si edhe të pikës 1 "b" dhe 1 "c" të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 64 datë 27.1.2016, "Për programin e nxitjes së punësimit të të rinjve, që kanë fituar statusin e jetimit"."

3. Pika 5, pjesa I "Klasifikimi buxhetor", paragrafi nënartikulli 6031200, "Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore" të ndrysho-het si më poshtë:

"Nënartikulli 6031200 "Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore",

Do të përbëhet nga shpenzimet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore, masa e së cilës përcaktohet në udhëzimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për pikën 1 "a" të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 48, datë 16.1.2008, i ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 27 datë 11.1.2012, i ndryshuar, të pikës 1 "b" dhe të pikës 1 "c" të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 199, datë 11.1.2012, i ndryshuar, të pikës 9 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 873, datë 27.12.2006, i ndryshuar, për pikën 7 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 47, datë 16.1.2008, të ndryshuar dhe pikave 1 dhe 2, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 248, datë 30.4.2014, të ndryshuar, si edhe të pikës 1 "b" dhe 1 "ç" të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 64, datë 27.1.2016, "Për programin e nxitjes së punësimit të të rinjve, që kanë fituar statusin e jetimit", paguhet kontributi për sigurimin nga aksidentet në punë.

4. Pika 5, pjesa I "Klasifikimi buxhetor", paragrafi nënartikulli 6031400 "Subvencion për të nxitur punësimin", të ndryshohet si më poshtë:

"Nënartikulli 6031400 "Subvencion për të nxitur punësimin"

Subvencionet përbëhen nga pagesat që kryhen nga drejtoritë rajonale të punësimit sipas pikës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 47, datë 16.1.2008, të ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 248 datë 30.4.2014, të ndryshuar, pikës 1 "a", të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 64, datë 27.1.2016, "Për programin e nxitjes së punësimit të të rinjve, që kanë fituar statusin e jetimit" si edhe të pikës 1 "a", të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 199, datë 11.1.2012, të ndryshuar. Ky subvencion t'i xhirohet çdo muaj subjektit, që aplikon programin e nxitjes së punësimit. Për sa i përket vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 873, datë 27.12.2006, të ndryshuar, subvencionohet vetëm punëkërkuesi.".

5. Pika 5, pjesa II "Procedurat e financimit", të ndryshohet si më poshtë:

"Për miratimin e projekteve fituese, zyra përkatëse e punësimit do të paraqesë pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimit, dokumenta-cionin që përcaktohet në vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 47, datë 16.1.2008, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 48, datë 16.1.2008, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 873, datë 27.12.2006, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 199, datë 11.1.2012, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 11.1.2012, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 248 datë 30.4.2014, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 64, datë 27.1.2016, "Për pro-gramin e nxitjes së punësimit të të rinjve, që kanë fituar statusin e jetimit, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre"."

6. Pika 6, pjesa II "Procedurat e financimit", të ndryshohet si më poshtë;

"Drejtoritë rajonale të punësimit do të financojnë projektet e nxitjes së punësimit (projektet e zyrave rajonale dhe zyrave vendore) sipas pikave 1 dhe 7 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 47, datë 16.1.2008, të ndryshuar, sipas pikës 1 "a" dhe "b", të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 48, datë 16.1.2008, të ndryshuar, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 873, datë 27.12.2006, të ndryshuar, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 199, datë 11.1.2012, të ndryshuar, sipas vendimit të Këshillit të Mini-strave nr. 27, datë 11.1.2012, të ndryshuar, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 248, datë 30.4.2014, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.

64 datë 27.1.2016, "Për programin e nxitjes së punësimit të të rinjve, që kanë fituar statusin e jetimit" mbas datës 10 të çdo muaji për aktivitetin e muajit të mëparshëm. Për muajin dhjetor xhirimi i fondeve do të bëhet brenda datës 31 dhjetor.".

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË
Blendi Klosi

MINISTRI I FINANCAVE
Arben Ahmetaj